



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJILAN - DEGA E GJYKATËS NOVOBËRD

Numri i lëndës: 2018:018344

Datë: 16.02.2021

Numri i dokumentit: 01513281

**P.nr.54/2017**

### **NË EMËR TË POPULLIT**

**GJYKATA THEMELORE NË GJILAN – DEGA NE NOVOBERDE–  
Departamenti i Pergjithshëm,** *permes Gjyqtares Emine Salihu, në lëndën penale kundër të akuzuarve I. T., nga Fsh.Z., K.Novobërdës, për shkak të veprës penale mospërfilja e gjykatës nga neni 401 par.1 të KPRK-së, dhe N. P., nga Prishtina, për shkak të veprës penale , shtytja ne kryerjen e vepres penale mospërfillja e gjykatës nga neni 401 par.1 lidhur me nenin 32 te KPRK-së, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore – Departamenti i pergjithshëm, PP.nr.1280/17, të dt.28.07.017, pas mbajtjes së shqyrtimeve fillestare te mabjtuara me datë 28.10.2019 , dhe 25.11.2019, pas mbajtjes së shqyrtimeve gjyqësore, orale dhe publike më dt. 02.11.2020, 21.12.2020, e që me datë 24.12.2020, në prezencën e prokurores së shtetit Leonora Kadriu, të akuzuarve I. T., dhe N.. P., dhe mbrojtësve te pandehurit N..P..., Av. Xhafer Maliqi, dhe Av.Afrim Salihu, muar dhe publikisht shpalli këtë:*

### **A K T G J Y K I M**

- I. *I akuzuari I.. T..i, me pseudonim “G..”, nga i ati H., dhe e ëma M..., e lindur R., i lindur më dt.11.05.1954, në .., me vendbanim të përhershëm në Fsh.Z., K.Novobërdë, si dhe në P..., Rr.”L.. L.”, nr.21, ka të kryer katër klasë të shkolles fillore, i martuar, babë i tre fëmijëve, blegtar, i gjendjes së mesme ekonomike, shqiptar, shtetas i R. të Kosovës, me parë i padënuar dhe nuk udhehiqet procedure per veper tjeter penale.*
- II. *I akuzuari N.. P..., me pseudonim “P..”, nga i ati I., dhe e ëma E..., e lindur N., i lindur më dt.11.01.1975, në P., ku edhe jeton Lagja”.....”, ka të kryer fakultetin e gjuhës angleze në P., punon si*

*pronar në ..... në ....., i martuar, babë i dy fëmijëve, i gjendjes së mesme ekonomike, shqiptar, shtetas i R. të Kosovës, më parë i padënuar dhe nuk udhëhiqet procedurë për vepër tjetër penale.*

## **ËSHTË FAJTORË**

### **I**

*I Akuzuari I. T.,*

*Sepse me datë 19.07.2017, rreth orës 11.20min, në Fsh.Z., të Komunës së Novobërdës, nuk i është bindur aktvendimit të plotefuqishem të Gjykatës Themelore në Gjilan, me shifër C.nr.41/13, te dates 06.06.2016, në ate menyre që hynë në pronën e cila ishte e përfshirë në masën e përkohshme me aktvendimin e lartpërmendur përmes së cilës masë paleve iu ishte ndaluar qfardo tjetërsimi etj, i ngastrave , në mesin e të cilave dhe i ngastrës në fjale dhe në bazë te autorizimit të N.. P..s, ( njëra prej paleve ne proceduren me të cilën kishte të bëjë ai aktvendim ), e kositë barin që ishte rrit në atë ngastër dhe në këtë mënyrë nuk iu kishte bindur aktvendimit te gjykatës në fjalë.*

*me çka ka kryer veprën penale Mospërfillja e gjykates nga neni 401 paragrafi 1 te KPK-së.*

*Andaj gjykata duke i bazuar në dispozitatat e cituara ligjore të nenit 3,41,43,46, 73 te KPRK-se, si dhe nenit 365 te KPPK-së,*

## **E GJYKON**

### **I**

*Me dënim me gjobë në shumë prej 300 (treqind ) euro të cilën gjobë i akuzuari ka për ta paguar pas potfuqishmërisë së këtij aktgjykim.*

*Po që se i akuzuari, denimin me gjobe nuk deshiron ose nuk mund ta paguaje, i njejt i do te i zevendesohet me denim me burgim, ku nje dite e burgut do te llogaritet me 20(njezete) euro te gjobes.*

*Kërkesë pasuroro-juridike nuk pati nga i dëmtuari S.. J..., nga Fsh.Z..., K.Novobërdës.*

*I akuzuari obligohet ti paguaj të gjitha shpenzimet e procedurës penale sipas llogarisë përfundimtare të gjykatës dhe në emër të paushallit gjyqësor shumë prej 25 €, te gjitha këto ne afat prej 15 ditesh nga dita e plotfuqishmërisë se këtij aktgjykimi.*

*Ne konfrom te nenit 39 par.3 nen par.3.1 te Ligjit per kompensimin e viktimave te krimi, i pandehuri I. T..i, obligohet te paguaje taksen ne shume prej 30 Euro.*

## **II**

*Ndaj të pandehurit N..P., në konform te nenit 363 par.1 pika 1.1 te Kodit te Procedures Penale,*

### **REFUZOHET AKUZA**

*Se ditën, kohën dhe vendin e përshkruar si në disoizitivin I të kësaj aktakuze, me dashje e shtyte personin tjetër të kryejë veprë penale te mosperfilljes se gjykates nga neni 401 par.1 te KPRK-se, ne ate menyre qe edhe pse si palë në procedurë e ka ditur se me aktvendimin e plotfuqishem të Gjykates Themelore ne Gjilan, me shifer C.nr.41/13, te dates 06.06.2016, ka qenë i ndaluar shfrytezimi i asaj ngastre kadastrale , ky e autorizon dhe ne kete menyre e shtyt te pandehurin e pare . T., qe te shkoje ne Fsh,Z., te Komunes se Novoberdes, dhe ta kosite barin ne kete ngaster e me kete ta kryej edhe veprën penale te mosperfilljes se gjykates.*

- *me çka ka kishte per te kryer veprën penale shtytja ne kryerjen e vepres penale mosperfillja e gjykates nga neni 401 par.1 lidhur me nenin 32 te KPRK-së.*
- *Shpenzimet e procedurës penale për veprën penale në dispozitivn II, të aktgjykimit bien në barre të mjeteve bugjetore të kësaj gjykate.*

### **A r s y e t i m**

*Prokuroria Themelore – Departamenti i pergjithshem- në Gjilan, me aktakuzën PP.nr.1280/17 të dt.28.07.2017, ka akuzuar të akuzuarit I. T., nga Fsh.Z., K.Novobërdës, për shkak të veprës penale mospërfillja e gjykatës nga neni 401 par.1 të KPRK-së, dhe N.. P., nga Prishtina, per shkak te vepres penale shtytja ne kryerjen e vepres penale, mosperfillja e gjykates nga neni 401 par.1 lidhur me nenin 32 te KPRK-se.*

*Në shqyrtimin gjyqësor Perfaqsesja e akuzes, në fjalën përfundimtare te shqyrtimit gjyqësor deklaroi: Duke e pas parasysh rrjedhën e këtij shqyrtimi gjyqësor si perfaqses i akuzës konsideroj se sa i përket të pandehurit I. T.. sipas dispozitivit I, të kësaj aktakuze në tërësi u vërtetua pertje dyshimit te bazuar se i njejtti ne kohen , vendin dhe mënyren e përshkruar ka kryer veprën penale mosperfillja e gjykatës nga neni 401 par.1 te KPRK-së. Kjo për faktin se sipas deklarates se te dëmtuarit i dëgjuar në cilësi të dëshmitarit ne kete seance S.. ,*

*me sytë e tij e ka parë duke e kositur parcelën kontestuese për të cilën ka qenë edhe vendimi mbi ndalimin, që përveq të tjerash edhe sipas vlerësimit ton fjala e tij, nenkupton edhe kete fakt . Gjithashtu një fakt të tillë e ka vertetuar edhe deshmitarja R.. M., se përveq se e ka kositë dy-tri here pas ketij vendimi edhe ia kam bërë me dije përsëri se ka nje vendim qe i ndalohet nje gje e tillë edhe atij e poashtu edhe atyre, se e te vertete i pandehuri I. , e ka pas këtë vendim ka qenë i njoftuar me përmbajtjen , poashtu është i vetdijshem se vendimet e gjykates duhet te perfillen, i njëjti e pohoi ne këtë seancë, përkunder se deklaroi se nuk e ka kositur, megjithatë ne nuk e kemi prit nje pohim te tille per fakatin se e ka kosite por kjo eshte vertetuar edhe me provat tjera e poashtu faktit se ne ditën e raportimit 19.07.2017, i pandehuri e ka pas këtë vendim, e ka dit përmbajtjen dhe po të mos ishte shfrytëzuar atehere pse do te paraqitej. Per me teper vet i pandehuri në keteshqyrtim e pohoi se i ka poseduar nje autorizim gjithnje sipas tij se këtë autorizim e ka poseduar vetem me qellim perfaqsimi qe do te thote se nuk i ka dhënë te drejta shitesë përveq atyre të cekura na autorizim, prandaj ju propozoj që të njëjtin ta shpallni fajtor dhe ti jepni një dënim meritor sipas ligjit dhe duke i patur parasysh te gjitha rrethanat qoft ato lehtesuese apo rëndesuese qe ndikojne ne llojin dhe lartësine e dënimit që me denimin e percaktuar te aaritet edhe qellimi i tij i parapre ne nenin 38 te KPRK-se.*

*Sa i perket dispozitivit II te kesaj aktakuze që i ngarkohet të pandehurit N. P., si përfaqsesi kauzës konsideroj se në asnjë provë te vetme nuk u provua fakti që i njëjti ta ketë shtytur që të mos perfille vendimin e gjykates , kjo sipas deklaratave të dëshmitareve të cilët në këtë shqyrtim e theksuan se asnjehere nuk e kanë takuar N. P., nuk kanë biseduar me te njëjtin perkunder përprjekjeve të tyre por I... T..i, nuk i ka lejuar apo ua ka pamundesuar, gjithashtu te nejjtit thane se as i pandehuri I., nuk u ka thënë ndonjehere se Nol Pashoja, ta kete shtyer për mos me e perfill këtë vendim e poashtu edhe vet i pandehuri I. T..., e pohoi bindshëm se as nuk ek a shtyte bile permes nje personi te tretë ia ka dorezuar kete vendim mbi ndalimin, e kam fjalën për masën e përkohshme , dhe konsideroj se këtë vendim po hamendësoj ia ka dorëzuar në menyrë që te njoftohet me përmbajtjen e tij, prandaj edhe iu propozoj gjykates që të merr aktgjykim refuzues sepse si përfaqses i akuzës heq dorë nga Dispozitivi II i kësaj aktakuze.*

*I demtuari S.. J., në fjalën përfundimtare të shqyrtimit gjyqesor Nuk i bashkangjitet ndjekjes penale ndaj te pandehurit dhe nuk kerkon kompensim demi, vetem kerkon nga i pandehuri I... T., qe ne te ardhmen te mos kete asnje problem.*

*Eshte vertete se lidhur me parcelat si në aktvendimin C.nr.41/2013, të datës 06.06.2016, e kam paraqitur me padi, ne gjykatë, dhe lidhur me padinë time te paraqitur ne gjykatë, nga gjykata e kam pranuar edhe aktvendimin C.nr.41/2013, te dates 06.06.2016. Konsideroj se aktvemdin e gjykatës me nr. dhe datë si më*

*lart i pandehuri N.. P., e ka respektuar, mirpo i p.. I.. T..., nuk e ka respektuar këtë vendim. Une te pandehurin N... P., e kam takuar vetëm një herë në katastrofë te Novoberdes, i cili më ka thënë se kam ardhur ta nxjerre fletën poseduese për të gjitha ngasrtat kadastrale, dhe unë nuk e kam njohur N.. P., por zyrtari i kadastrës më ka thënë se ky është personi që i ka blerë parcelat në fjalë. Para vendimit të gjykatës kam patur disa mosmarrveshje me të pandehurin I.. T., lidhur me bagëtitë të cilat i ka futur në oborrin tim për ti kullotur- me të njëjtin jemi fqinjë. Pas marrjes së këtij vendimi Ibrahim Termkolli, e ka kositur barin në parcelën të cekur në aktvendim. Unë nuk kam njohuri se N..P..e ka shti I.. T., që ta kositë barin në oborrin dhe arën time- gjegjesisht në parcelën si në aktvendim. Unë me sytë e mi e kam parë se I.. T., e ka kosit barin në parcelën në fjalë. Unë me të njëjtin kam tentuar që të arrijë një marrveshje por i njëjti nuk ka pranuar, dhe më ka thënë se posedon dokument se kjo është pronë e N., dhe më ka treguar një autorizim por pasi që ka qenë në gjuhën shqipe unë nuk e kam kuptuar, ndërsa ndonjë aktvendim të gjykatës i njëjti nuk më ka prezentuar.*

*Unë qdo ditë kaloj, meqë nëpër atë livadh shpije rruga për të shtëpia ime. Asnjëherë N.. P., nuk më ka penguar që të kaloj nëpër atë livadh, Dy vite me radhë I.. e ka kosit këto livadh, derisa policia ka intervenuar për afërsisht para tri viteve, dhe i njëjti asnjëherë më nuk ka kositur bari në këtë parcelë, i njëjti ka kositur oborrin dhe livadhin, 90 % e di se ku është megja ime, ngastren të cilën e ka blerë N..i – oborrin evidentohet me të njëjtin nr. katastral me ngastrën që ka qenë e imja, gjykata ka prurë aktvendim që masa e përkohshme vlen për tërë ngastren. Bashkëshorjta ime e ka paraqitur rastin konkret në polici. Unë ditën kur e kam takuar të pandehurin I.. T., në arën time nuk kam njohuri se i njëjti a ka qenë në dijeni lidhur me aktvendimin e gjykatës. I., atë ditë nuk më ka njoftuar lidhur me ndonjë vendim të gjykatës.*

*Dëshmitarja R..e M., në fjalën përfundimtare të shqyrtimit gjyqësor deklaroi: Unë jam e njoftuar lidhur me aktvendimin e gjykatës C.nr.41/13 të datës 06.06.2016, dhe jam në tërësi e njoftuar lidhur me përmbajtjen e këtij aktvendimi. I... T... e kam fqi të parë, ndërsa të pandehurin N. P., për herë të parë e shoh sod në gjykatë i cili e ka blerë parcelën të cekur si në aktvendimin si më parë. Unë nuk kam njohuri se N.. P., e ka shtyt të pandehurin I.. T., që ta kositë barin në parcelën kontesutese tonën, Une kam njohuri se I.. e ka kositur barin. Une disa herë i kam parë me sytë e mi se I.. T..i, e ka kositur barin e parcelës në fjalë, meqë i njëjti nuk u ndalte duke kositur atëherë e kam thirrë me telefon policinë të cilët kanë ardhur menjëherë dhe e kanë parë se i njëjti ishte duke e mbledhur barin. I.. T...i, edhe pas marrjes së aktvendimit prej gjykatës ka vazhduar kositjen e barit në parcelën e cila është aktuale në aktakuzë. Përveq kositjes së barit nuk është ndërmarë kurrfarë veprimi tjetër nga ana e të pandehurve. Unë nuk e di nëse ka qenë i njoftuar me aktvendimin e gjykatës I.. T... Edhe unë edhe bashkëshorti im ia kemi prezentuar disa herë aktvendimin e gjykatës I..., por gjithnjë i njëjti është*

*përgjegjur se ajo është pronë e imja. Shtoj edhe kete se gjate prezentimit te aktvendimit i kemi thene I..t se nuk kemi te drejte as ti as na që ti shfrytëzojmë këto ngastra kadastrale . I njëjti asnjëherë nuk na ka prezentuar ndonjë dokument se është pronë e tij. I., asnjëherë nuk na ka thënë se N... ta ketë shtyer ta kositë barin në parcelën në fjalë. Pasi që e kam lajmëruar policinë I., më nuk ka ardhur për të na penguar-kositur barin. I.. asnjëherë nuk ka na prezentuar ndonjë autorizim të N... Vetëm gojarisht na thojke se është i autorizuar nga N... që ta bëjë kositjen e barit në parcelen në fjalë. I..., her thojke është tokë e imja e her N... ma ka dhënë autorizimin, dhe unë kam të drejtë të bëj qkado. Meqë nuk kam mundur të bie në kontakt me N..., disa herë kam tentuar përmes I..t, që të kontaktoj me të mirpo I. , nuk na ka dhënë mundësinë- as nuk ka ka dhënë nr e telefonit, dhe të mos kemi asnjë kontakt me te.*

*Atë ditë kur e kam njoftuar policinë i kam thënë këtë se I.. T..., nuk i përmbahet aktvendimit të gjykatës. Oborri është i kufizuar në tri anët me gardh, se kam shikuar se a është në tri anët e rrethuar. Po, Unë me sytë e mi të kam parë disa herë duke kositur barin në ngastrat kontestuese.*

*Nuk më kujtohet se mbas sa kohe e kam marrë vendimin e gjykates.*

*E keni pasë në dorë dhe a e keni lexuar atë aktvendim. Po ka qenë në gjuhën shqipe dhe e kuptoj përmbajtjen e saj në tërësi.*

*Nuk kemi marrur kurfarë vendimi tjetër lidhur me ngastrat kontestuese, përveq aktvendimit të gjykatës me nr C.Nr.41/2013, të datës 06.06.2016,- Masën e përkohshme. Përveq që kemi tentuar ta gjejmë edhe të pandehurin N..P., përmes I., nuk kemi patur mundesi të tjera të kontaktojmë me ndonjë person për ta njohur N.. P., dhe nuk kemi patur kënd ta pyesim meqe I..i nuk ka dhënë siq thashë edhe më lart kurfarë mundesië që të takohemi me të pandheurin N..P...*

*Meqense në seancë nuk ka prezentuar dëshmitari M.. B..., me propozimin e PSH, të përkrahur edhe nga mbrojtësi i të pandehurit N..P..., Av.Xhafer Maliqi, gjykata ka lexuar deklaratë-raportin e dëshmitarit i hartuar me date 19.07.2017, ku citon” Me date 19.07.2017, rreth orës 11.20min, kemi marre nje tel.nga ankuesja R.. M., nga babai I., me qëndrim me Fsh.Z., e cila njoftoi se fqiu i saj , i dyshuari I.. T., ka kositur ne parcelen të cilën e kanë pasur në proces gjyqësor. Ne kemi kontaktuar me ankuesen , e kemi intervistuar dhe kemi shikuar vendimin e gjykatës të cilën e kemi bërë kopje të vendimit. Pas shiqimit të vendimit kemi kontaktuar me të dyshuarin ku i njëjti kishte autorizim për shfrytëzim nga N.. I.. P..a, nga Prishtina, ku i njëjti sipas tij nuk kishte njohuri lidhur me vendimin të cilin e kishte marrë gjykata me datë 06.06.2016. Ne kemi kontaktuar me prokurorin e shtetit i cili na udhëzoi që rasti të shkoj në procedurë të rregullt me kallëxim penal.*

*Gjykata ka refuzuar propozimin e të pandehurit I.. T..i, që në cilësi të dëshmitarit të dëgjohet .L.. ..i, nga Prishtina, meqë gjykata ka konstatuar se të njëjtin e ka fqinjë dhe do të ndikon i pandehuri tek dëshmitari, dhe se gjykata ka konstatuar se dëgjimi i tij është dëshmi irelevante për ndriqimin e gjendjes faktike.*

*I akuzuari I.. T..i, gjatë fazës së hetimeve, si dhe gjatë shqyrtimeve të mbajtura gjyqësore ka mohuar kryerjen e veprës penale në fjalë, e i cili deklaroi: Të dëmtuarin S.. J.., e kam fqinjë te parë, nuk kemi raporte të mira me të, për arsye se S.., ma qet bërlllogun para dyerve të mija, nuk e rrethon gardhin, hin bagëtitë në oborr. Dhe shpeshherë këta e kanë thirrë policinë për problemet e tilla, gjithashtu edhe unë disa herë e kam ftuar policinë, për këto shqetësime, unë vendimin e gjykatës themeloren e Gjilan –dega në Novobërdë me nr. Cnr.41/2013, të datës 06.06.2016, e kam pasur dhe e di përmbajtjen e këtij vendimi, këtë vendim ma ka dërguar i pandehuri N..P..a, përmes dajës tim E.. R.., sepse N.. e kam parë vetëm një herë.*

*N.. P.., e kam parë vetëm ditën kur ma ka dhënë autorizimin, autorizimin ma ka dhënë përafërsisht një vit para se të caktohet masa e ndalimit, N.. ma ka dhënë autorizimin, që unë ti ndjek procedurat gjyqësore në Gjykatë, lidhur me këtë ndalesë për shkak që ajo gjendet jashtë shtetit, me këtë autorizim kam nenskutpuar se e kam qdo të drejtë në procedure. Noli, nuk më ka thënë që unë ta kosis barin , pas vendimit të gjykatës atë parcelë nuk e kam shfrytëzuar kurrë as unë e askush tjetër.*

*se kurrë nuk e kam kositur barin as une e askush tjetër.*

*Unë nuk kam biseduar me askënd lidhur me ndalimin e vendimit të gjykatës. Ky e di që e ka gardhin, ky e di se nuk është pronë e tij. Me N.., nuk kam fol kurrë e as nuk e kam parë kurrë, e as nuk më ka thënë të zihem me fqinjë. Unë jam i vetëdijshëm që vendimi i gjykatës duhet të përfilllet.*

*Unë sod e kësaj dite nuk e shfrytëzoj këtë parcelë sepse është e mbushur në therra. Dy-tri herë e kam parë me sytë e mi se I. T..i, e ka kositur barin në parcelën e ndaluar. Noli nuk më ka thënë asnjehere që mos ta kosit barin .*

*I pandehuri N.. P.., në shqyrtimin e mbajtur gjyqësor , në prezencë të mbrojtësve të tij ka shfrytëzuar të drejtën ligjore për tu mbrojtur në heshtje.*

*Me provat e proceduara në shqyrtimin publik gjyqësor dhe vlerësimin e tyre veq e veq në lidhje me provat tjera në konfrom të nenit 361 të KPPK-së, gjykata gjeti se i akuzuari I.. T..i, ka kryer veprën penale mospërfillja e gjykatës nga neni 401 par.1 të KPRK-së.*

*Këtë gjendje faktike gjykata e vërtetoi përmes dëshmisë së të dëmtuarit S.. J.., dëshmitares R..e M., leximin e deklaratës-raportit të dëshmitarit .M. B.., i hartuar më datë 19.07.2017, pjesërisht nga mbrojtja e të akuzuarit I.. T..i, provave*

*materiale, aktvendimit të Gjykatës Themelore në Gjilan, Dega në Novobërdë-  
Departamenti i përgjithshëm- Divizioni Civil, C.nr.41/2013, të datës 06.06.2016.*

*Nga deklarata e të dëmtuarit S. J., vërtetohet se, edhe pse i dëmtuari dhe  
dëshmitarja R. M., i 'a kanë prezentuar të pandehurit ..I. T..li, Aktvendimin e  
Gjykatës Themelore në Gjilan-Dega në Novobërdë, C.nr.41/2013, të datës  
06.06.2016, dhe e kanë njoftuar se aktvendimi është i plotfuqishëm, i njëjti  
përseri ka hyrë në pronën e cila ishte e përfshirë në masën e përkohshme mirpo i  
njëjti edhe përkunder këtij njoftimi dy vite me radhë ka kositur barin, përmes se  
cilës palëve iu është ndaluar qfardo tjetërsimi etj. i ngastrave në fjale, edhe pse i  
dëmtuari ka tentuar disa herë të gjen ndonjë marrëveshje me të njëjtin, por i njëjti  
nuk ka pranuar duke aluduar se posedon një autorizim se kjo është pronë e N..t ,  
dhe ka të drejtë të bëjë qkado në pronën e tij .*

*Nga deklarata e dëshmitares R. M..j ( bashkëshorte e të dëmtuarit S..), vërtetohet  
dëshmia identike me deklaratën e të dëmtuarit S.. J.., të dhënë në shqyrtimin e  
mbajtur gjyqësor.*

*Gjykata, edhe nga mbrojtja e të pandehurit I.. T.., ka vërtetuar se aktvendimin e  
Gjykatës C.nr.41/2013 të datës 06.06.2016, e ka poseduar, të cilin vendim ia  
kishte derguar N.. P.., përmes dajës së të pandehurit I.., me emrin E.. R.., i cili  
edhe ka deklaruar se e ka ditur përmbajtjen e aktvendimit në fjalë, të masës së  
përkohshme, fare nuk ia ka perfille por ka vazhduar me kositjen e barit në  
ngastren e palejuar.*

*Gjykata gjithashtu ka vlerësuar edhe mbrojtjen e të akuzuarit I.. T.., por që  
mbrojtjes së tij pjesërisht ia fali besimin, sepse mbrojtja e tij nuk ka patur  
mbështetje në provat, ato kanë qenë të orientuara me qëllim të ikjes nga  
përgjegjësia penale – apo në zvogëlimin e përgjegjësisë së tij penale dhe se  
mbrojtja e tij është në kundërshtim me të gjitha provat tjera që gjykata i ka  
administruar gjatë shqyrtimit gjyqësor, prova këto të cilat në mënyrë të qartë, të  
plotë dhe bindëse kanë vërtetuar se i akuzuari ka kryer veprën penale me të cilën  
u akuzua dhe u shpall fajtor.*

*Gjykata pas vlerësimit të provave të shtjelluara në shqyrtimin gjyqësor që kanë të  
bëjnë me përgjegjësinë penale të akuzuarit, nuk ka gjetur asnjë bazë për  
përrjashtimin e përgjegjësisë së tij penale, andaj edhe të njëjtin e ka shpallur  
fajtor dhe penalisht përgjegjës për kryerjen e veprës penale.*

*Me rastin e vendosjes lidhur me llojin dhe lartësinë e dënimit gjykata i ka  
vlerësuar të gjitha rrethanat lehtësuese dhe rënduese, në kuptim të nenit 73 të  
KPK-se, të cilat janë në ndikim me caktimin e lartësisë dhe llojit të dënimit për të  
akuzuarin. Kështu si rrethanë lehtësuese për të akuzuarin I. T.., se më parë nuk*



*ka qenë i dënuar , nuk udhëhiqet procedurës edhe për vepër tjeter penale, nuk ka mundur të kuptojë pasojën e kësaj veprës penale, i dëmtuari nuk i bashkangjitet ndjekjes penale ndaj të njëjtit, ndërsa si rrethanë rënduese mori parasysh peshën e kryerjes së veprës penale, dhe rrezikshmërisë shoqërore të të njëjtës.*

*Duke pasur parasysh rrethanat e cekura më lartë gjykata gjen se me dënimin e shqiptuar si ne dispozitiv te aktgjykimit, do të arrihet qëllimi i ndëshkimit te parapare me nenin 41 te KPRK-se, i cili do të ndikon në ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për rrespektimin e ligjit si masë për parandalimin e të akuzuarit dhe personave të tjerë nga kryerja e veprave penale në të ardhmen.*

*Përfaqësuesja e akuzës, pas mbajtjes së shqyrtimit gjyqësor, shtjellimit dhe administrimit të provave personale dhe materiale, gjatë fjalës përfundimtare në mungesë të provave është tërhequr nga akuza ndaj të pandehurit N.. P., për shkak të veprës penale shtytja në kryerjen e veprës penale – mosperfillja e gjykatës nga neni 401 par.1 lidhur me nenin 32 te KPRK-së, deklarimin e të akuzuarit ...I.. T...li, të dëmtuarit dhe dëshmitareve që janë dëgjuar, sikurse edhe nga provat tjera materiale që janë shtjelluar , meqense provat dhe faktet konkrete treguan se i akuzuari nuk rezulton të jetë e kryes i veprës penale, andaj edhe në pajtim të nenit 363 par.1 pika 1.1 te KPPK-se, në mungesë te provave është tërhequr nga akuza.*

*Gjykata ka vendosur të refuzojë akuzën në kuptim të nenit 363 par.1 pika 1.1 te KPPK-se, meqenëse prokurori i shtetit ka hequr dorë nga e njëjta pasi që nuk u vërtetua që i pandehuri N... P., ka kryer veprën penale të cekur si më lartë. Këtë e bazojmë në deklarimin e të akuzuarit I.. T..i, i cili në menyre te qarte dhe bindese deklaroi se nuk i ka ndërmarre veprimet te cilat ia ve ne barre akuza e e cila, kishte mbështetje edhe në provat tjera personale dhe materiale që u administruan gjatë këtij shqyrtimi gjyqësor, e që si përfundim arritën edhe ta bindim prokurorin e shtetit të heq dorë nga ndjekja penale e që në këtë kontest duhet të veprohet ne favor të të pandehurve andaj edhe gjykata ka vlerësuar se në veprimet e të pandehurit nuk përmbahen elemente të veprës penale për të cilën ka qenë i akuzuar.*

*Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale për të pandehurin I..T..., është bazuar në dispozitën e nenit 451 të KPPK-ës, ndërsa shpenzimet e procedurës penale për veprën penale në dispozitivin II të aktgjykimit, ne konfrom te nenit 454 par.1 të KPPK-së, bien në barrë të mjeteve bugjetore të kësaj gjykate.*

*Nga të cekurat e mësipërme e në bazë të nenit 365 të KPPK-ës, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.*

**GJYKATA THEMEORE NË GJILAN- DEGA NOVOBERDE**  
**DEPARTAMENTI I PERGJITHSHEM**  
**Më dt. 24.12.2020**

**Ref.Larte**  
*Mimoza Mehmeti*

**Gjyqtarja**  
*Emine Salihu*

**E DREJTA NË ANKESË** : Kundër këtij aktgjykimit mund të ushtrohet ankesë Gjykatës Apelit në Prishtinë , në afat prej 15 ditësh, nga dita e pranimit të këtij aktgjykimit , e nëpërmes të kësaj gjykate.

Numri i lëndës: 2018:018344  
Datë: 16.02.2021  
Numri i dokumentit: 01513281